



Republika e Kosovës
Qeveria
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Republika e Shqipërisë
Qeveria
Ministria e Kulturës

Nr. _____ Prot.
Data __.__.2017

Nr. _____ Prot.
Data __.__.2017

PROTOKOLL BASHKËPUNIMI

BAZUAR NË “DEKLARATËN E PËRBASHKËT PËR BASHKËPUNIM DHE PARTNERITET STRATEGJIK NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS” I DATËS 11 JANAR 2014

I LIDHUR

NDËRMJET MINISTRISË SË KULTURËS TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

DHE

MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Duke iu referuar Protokollit të bashkëpunimit të lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës, bazuar në “Deklaratën e përbashkët për bashkëpunim dhe partneritet strategjik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Kosovës” nënshkruar në Prizren, më datë 11 janar 2014, me qëllim të themelimit të Kalendarit të Përbashkët Kulturor Vjetor, si dhe të bashkërendimit të aktiviteteve kulturore për Kalendarin, parashikohen në kapitullin 3 detyrimet e palëve dhe në kapitullin 4 zbatimi i Protokollit të bashkëpunimit.

Protokolli i Bashkëpunimit, në kapitullin 7, parashikon se palët me marrëveshje mund të plotësojnë dhe ndryshojnë listën e aktiviteteve të përfshira në Kalendarin e Përbashkët Kulturor Vjetor.

Në përputhje me parashikimet e Protokollit të Bashkëpunimit, paragrafin 3 dhe paragrafin 7, Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Republikës së Kosovës, bien dakord për përfshirjen e aktiviteteve të mëposhtme në Kalendarin e Përbashkët Vjetor për vitin 2017:

Libri

Aktivitete të përbashkëta të konsultuara mes Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë dhe Bibliotekës Kombëtare të Kosovës

- Ekspozita dhe konferenca për 100-vjetorin e lindjes së **Musine Kokalarit** –Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë dhe e Kosovës; Prishtinë, prill 2017.
- Java e Bibliotekës në Kosovë organizuar në bashkëpunim me Bibliotekën Kombëtare të Kosovës dhe Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë; Prishtinë, prill 2017.
- Anton Pashku- vepra, kritika, perceptimi në dy areale letrare: Ekspozitë në 80-vjetorin e lindjes e përgatitur nga Biblioteka Kombëtare e Kosovës dhe “Tryezë e rrumbullakët”, organizuar nga Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë dhe e Kosovës, Tiranë (fundi i majit).
- Trajnime në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë, në vijueshmëri.
- Krijimi i hapësirës për promovime të rregullta të botimeve nga Kosova (në hapësirat e MK-së në Shqipëri), në vijueshmëri.
- Përfshirja e autorëve kosovarë dhe veprave të tyre në portalin “Albanian Books”, në vijueshmëri.

KONFERENCË SHKENCORE: LETËRSIA, KUJTESA DHE KULTURA NACIONALE (Prishtinë)

- Pasqyrimi i ideve kulturore në letërsi

Aktivitetet përcjellëse:

- Ekspozitë e hartave të hershme të Arbërisë mesjetare –reproduksion;
- Ekspozitë e teksteve të autorëve të vjetër dhe e botimeve për ta.

Folklori

Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike do të përfshijë në aktivitetet e saj grupet nga Kosova.

Do të ftohen grupe nga Kosova:

- Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Valles Popullore, që do të zhvillohet në Lushnjë, në maj 2017, do të ftohen për të marrë pjesë 2-3 grupe vallesh nga Kosova.
- Festivali Folklorik Tipologjik i Lojërave dhe Riteve Popullore që do të zhvillohet në Berat, në muajin shtator 2017, do të ftohen të marrin pjesë 1-2 grupe nga Kosova.
- Veprimtaria “Ahengu Shkodran-Kryevepër e Trashëgimisë Kombëtare” që do të zhvillohet më 29 shtator në qytetin e Shkodrës, “Ditën Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore”, do të ftohen grupe nga Peja, Gjakova e Prizreni ku gjallon kjo tipologji.
- Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Iso-polifonisë që do të zhvillohen në qytetin e Vlorës, më 20-21 nëntor 2017, do të ftohet një grup nga Kosova.
- Palët, për çdo fillim viti, do të shkëmbejnë një informacion të plotë e të saktë për Kalendarin vjetor të veprimtarive të trashëgimisë kulturore jomateriale dhe diversitetit kulturor që zhvillohen në vendet respektive për pjesëmarrje reciproke.

Teatri

- Teatri Kombëtar i Shqipërisë parashikon të organizojë në muajin dhjetor 2017 “*Takimin Mbarëkombëtar të Dramës Shqipe*”, ku sugjerohet pjesëmarrja dhe mbështetja e trupave teatrore nga Kosova.
- Pjesëmarrja e trupës shqiptare të Teatrit Eksperimental “Kujtim Spahivogli” në muajin shtator 2017, me pjesën “E vërteta e Marias” në Teatrin Kombëtar të Kosovës.
- Në muajin maj dhe shtator 2017 do të ftohet trupa nga Kosova për të shfaqur produksionet në skenën e TKEKS-së.

- Teatri Kombëtar i Kosovës planifikon të organizojë tribuna teatrore, në të cilat do të trajtoheshin problemet estetike, teorike, realizuese të teatrit dhe të dramës. Bartës i njërës tribunë, që do të organizohet në Prishtinë, do të jetë regjisori me famë botërore, [Roberto Ciulli - Theater an der Ruhr](#), kurse tema e kësaj tribune do të jetë “Teatri avangard evropian – influencë në teatrin shqiptar”.
- TKK-ja do të organizojë të paktën edhe një tribunë, e cila do të ketë si bosht temën: Drama moderne shqiptare. Propozimi është që kjo tribunë të realizohet si projekt i përbashkët me referues të përzier nga Kosova dhe Shqipëria. (*Propozohet që të përfshihet në muajin dhjetor 2017 në Takimin Mbarëkombëtar të Dramës Shqipe*).

Filmi

- Qendra Kinematografike e Kosovës ka 2 aktivitete të përbashkëta me QKK-në e Shqipërisë. Kosova ka stenda në dy tregjet e filmit, në Berlinale dhe Cannes Film Festival. Në vitin 2017 në këto tregje do të ndahen stendat bashkë me QKK-në e Shqipërisë. Berlinale është në muajin shkurt dhe Cannes në muajin maj.
- Janë planifikuar në faza të ndryshme të prodhimit projekte dhe filma artistikë; bashkëprodhime me financim publik nga Shqipëria dhe Kosova.
- Me qenë se në vitin 2017 është edhe 20-vjetori i krijimit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë do të organizohen shumë aktivitete, ndër të cilat më të rëndësishme do të jenë "Festivali i 14-të i filmit shqiptar" dhe "Forumi Ndërkombëtar” ku do të lansohet zyrtarisht ideja e Ballkan dhe Adriatic Film Fond, si dhe ngjarje të tjera, ku partnerët institucionalë të Kosovës, por edhe faktorët e kinematografisë në Kosovë, do të jenë prezentë.
- Bashkëpunime të Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit Shqiptar në festivale të ndryshme që zhvillohen në Kosovë.

CIRKU KOMBËTAR

- Aktivitet kulturor në Prizren, në muajin mars.
- Aktivitet kulturor në Gjakovë, në muajin mars.

Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë

- 26-28 maj mbahet Festivali Mbarëkombëtar Folklorik për Fëmijë, me pjesëmarrjen e Ansambllit Artistik të Fëmijëve të qytetit të Prishtinës.
- Në muajin shtator Ansambli i Fëmijëve të Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë do marrë pjesë në Festivalin Ndërkombëtar të Fëmijëve “Ylberi i Prishtinës”, i cili do të zhvillohet në Prishtinë.

Galeria Kombëtare e Arteve

- Nga Galeria Kombëtare e Arteve në Tiranë do të organizohet ekspozita Xhevdet Xhafës nga Kosova – shtator-tetor në GKA.
- Galeria Kombëtare e Kosovës do të organizojë ekspozitën e Zef Shoshit nga Shqipëria, mars- prill, GKK.
- Galeria e Ministrisë së Kulturës në Kosovë do të organizojë ekspozitën grafike “Dëshirat dhe frikët e një qyteti”, të artistit grafik Artan Draçini.

TKOB

- Për vitin 2017, Ansambli “Shota” planifikon që sërish që të ftojë AP-në, në Koncertin e Pranverës, që në këtë vit ka edhe një të veçantë: organizohet për të nderuar doajenin e Ansambllit “Shota”, z. Ismet Bogujevci.
- Përgatitja e një koncerti të përbashkët tematik, me trupat e të dy ansambleve, i cili do të shfaqej të paktën në Prishtinë dhe Tiranë, por edhe në qendrat e tjera kryesore të Shqipërisë dhe Kosovës.
- Trimat e Jutbinës
- Veprat: Opera “Skënderbeu”
- Opera “Traviata”

Filarmonia e Kosovës

- Filarmonia e Kosovës planifikon realizimin e një koncerti vokalo-instrumental me solistët vokalë, korin profesional dhe orkestrën simfonike të institucionit tonë që do të mbahet në Tiranë. Programi koncertal do të përfshijë veprën “Magnificat” të autorit John Rutter dhe Meshën në C-dur të kompozitorit L.v.Beethoven.

ZSHDA

- Nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit midis dy zyrave respektive të të drejtës së autorit.
- Sa i takon propozimeve të tjera konkrete, të dy zyrat homologe janë pjesë e aktiviteteve të përbashkëta që zhvillohen në fushën e të drejtës së autorit.

TRASHËGIMIA

Trajnime në fushën e trashëgimisë materiale, jomateriale dhe restaurimeve.

- **Trajnim (cikël leksionesh)**, Menaxhimi Trashëgimisë Kulturore, Tiranë, tetor;
Organizatorët: Ministria e Kulturës (IMK) Pjesëmarrësit: Stafet e institucioneve përgjegjëse MK-të Kosovë-Shqipëri dhe të DRKK-ve. Ky aktivitet do të zhvillohet si një cikël leksionesh në Qendrën e Konservimit të Evropës Juglindore pranë IMK-së. Trajnimi ka për qëllim aftësimin dhe njohjen e stafeve të reja në institucionet respektive.
- Konferencë në Tiranë: Seminar/workshop: “Trafiku i paligjshëm i objekteve të trashëgimisë kulturore, urat e bashkëpunimit ndërinstitucional Shqipëri - Kosovë në luftë kundër trafikimit të pasurive kulturore”, Tetor. Organizatorët: Ministria e Kulturës (DTMM & QKIPK), Ministria e Kulturës së Kosovës. Pjesëmarrësit: Institucionet përgjegjëse në Shqipëri dhe Kosovë si aktorë kryesorë në luftën kundër trafikimit (Policitë e Shtetit të dy vendeve; Interpoli; Doganat; Prokuroria; Institucionet që administrojnë objekte të pasurive kulturore në të dy vendet respektive).
- Ekspozita fotografike e Dhimitër Vangjelit, një trashëgimi e shpëtuar dhe e dokumentuar. Prishtinë, Kosovë, maj; Organizatorët: Ministria e Kulturës (QKIPK) dhe Bashkia Kolonjë. Pjesëmarrësit: Stafet e institucioneve përgjegjëse, MK-të Kosovë-Shqipëri, Bashkia Kolonjë, publiku.
- Konkursi ndërkombëtar “Wiki Loves Monuments”.

Mbështetja e hapësirës së përbashkët kulturore:

- Angazhim për të mbështetur bashkëpunime midis artistëve dhe organizatave të të dy vendeve duke vënë në dispozicion një fond special nga fondet e Ministrive respektive që t’i dedikohen aktiviteteve që nxisin bashkëpunime mes dy vendeve.

Ky dokument hyn në fuqi prej datës së nënshkrimit nga palët dhe do të përbëjë Addendum Nr.2 të Protokollit të Bashkëpunimit.

Mirela KUMBARO FURXHI
Ministre e Kulturës së Republikës së Shqipërisë



Kujtim SHALA
Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit
i Republikës së Kosovës

